

INFORMACION RRETH POLICISE BASHKIAKE KAMEZ

Mbi krijimin dhe zhvillimin e Strukturës të Policisë Bashkiake, misionin e saj dhe detyrat që kryen bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore.

Policia Bashkiake ka tashmë një përvojë pune mbi 17 vjeçare e cila ka rezultuar e sukseshme, por njëkohësisht është përballur me shumë probleme të cilave përgjithësisht u është dhënë zgjidhje sipas normave ligjore ku mbështetet gjithë veprimtaria e saj.

Misioni dhe përgjegjësitë e Policisë Bashkiake përcaktohen në nenin 1 të ligjit nr 8224 datë 15. 05. 1997 “ Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe Komunës”, ku shprehet qartë se:

“Policia Bashkiake dhe e Komunës është organ ekzekutiv që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë apo komunës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore”.

Detyrat e Policisë Bashkiake përcaktohen qartë në nenin 8 të këtij ligji, përfshihen edhe drejtimit e punës dhe veprimtarisë së kësaj policie. Realizimi i këtyre detyrave bazohet në këtë ligj por edhe në ligje dhe akte të tjera nënligjore që lidhen me të gjithë aktivitetin që realizojnë organet e qeverisjes vendore.

Policia Bashkiake:

Është organ ekzekutiv i përfshirë në strukturën e aparatit të Bashkisë dhe në varësi direkte të Kryetarit të Bashkisë.

Vepron si strukturë më vete dhe drejtohet nga Kryeinspektori i Policisë Bashkiake.

Shërbimi i Policisë Bashkiake si strukture organizative, ekzekutive pranë Bashkisë, punën e saj e kryen në bazë të ligjit 8224 dt.15.07.1997, “ Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe Komunës”, i ndryshur, si edhe në rregulloren Tip të Policisë Bashkiake.

Nuk është pjesë përbërëse e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, por gëzon mbrojtje ligjore njëloj me punonjësit e policisë së shtetit.

Punon për sigurimin e zbatimit efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë si edhe nga Këshilli Bashkiak të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e rendit dhe të qetësisë si edhe mbarëvajtjen e punëve publike.

Siguron zbatimin e urdhërave të nxjerra nga Kryetari që kanë të bëjnë me persona juridikë e fizikë të cilët nuk plotësojnë detyrimet ligjore, fiskale apo çdo detyrim tjetër pasuror.

Merr masat e duhura duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse të Bashkisë dhe ato jashtë saj për të garantuar mbrojtjen e ambientit nga ndotjet;

Informon Kryetarin e Bashkisë për rastet e epidemive;

Konstaton e shmangë ndërtimet pa leje, zënien e trojeve në mënyrë të paligjshme, të ndërtesave e subjekteve publike të Bashkisë;

Merr masa për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike duke shmangur zëniet, zhurmat, përdorimin e altoparlanteve, borive, si edhe veprime të tjera që u shkaktojnë shqetësime qytetarëve;

Merr masa për ruajtjen dhe sigurimin e rendit kur ka grumbullime publike si në treg , në raste ceremonish publike , artistike , fetare , sportive etj;

Kërkon respektimin e dispozitave ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjedise publike si edhe respektimin e orarit të shërbimit të njësive tregëtare;

Aktivizohet dhe ndihmon në parandalimin dhe evitimin e fatkeqësive të ndryshme;

Në përmbushjen e detyrave të saj Policia Bashkiake bashkërendon punën edhe me Drejtori e zyra të tjera të aparatit të Bashkisë, sidomos me DPTTV-në, IMT-në, AMK-në, shërbimet publike, juridike, etj.

Bashkëpunim të veçantë Policia Bashkiake do të ketë edhe me Policinë Vendore për të gjitha problemet.

Punon me plan mujor dhe vjetor i cili miratohet nga Kryetari i Bashkisë.

Mban uniformën e vet dhe stemën e Bashkisë.

Kryen edhe detyra të tjera operative që ia ngarkon Kryetari i Bashkisë

Akte ligjore

Ligji nr 8224 datë 15. 05. 1997 “ Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe Komunës”

Rregullorja “ TIP “ e Policisë të Bashkisë e Komunës.

Ligji “ 139/2015 Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ”,

Kodi Rrugor të Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin Nr. 8378 datë 22.07.1998, i ndryshuar

Akte të tjera nënligjore si dhe Vendime të Këshillit të Ministrave, Vendime të Këshillit Bashkiak dhe Urdhëra të Kryetarit të Bashkisë.

Veprimtaria e Policisë Bashkiake

Policia Bashkiake ka aktualisht nje efektiv prej 29 punonjesish

1 Kryeinspektor,

7 Inspektorë,

17 Policë.

4 Roje.

Objekti i punës së Policisë Bashkiake është:

Zbatimi efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari dhe Këshilli i Bashkisë

Ruajtja e pasurisë së Bashkisë dhe objekteve në administrim të saj.

Kontrolli e subjekteve të biznesit që nuk plotësojnë konformë ligjit detyrimet financiare ndaj Bashkisë dhe marrja e masave përkatëse.

Mbajtja në kontroll e hapësirave publike dhe lirimi i tyre kur ato janë të zëna nga tregtar ambulantë ose me liçencë, por që nuk kanë paguar detyrimet për hapësirat publike.

Konstatimi, parandalimi dhe ndëshkimi i kundravajtësve administrativ për ndotjen e mjedisit, hedhjen e mbeturinave të ndryshme.

Konstatimi dhe ndëshkimi i kundravajtësve administrativ në fushën e Qarkullimit Rrugor

Dhënia e ndihmës në çdo kohë dhe rrethanë qytetarëve për objektin e punës së Policisë Bashkiake etj

Parandalimi i ndërtimeve pa leje, pezullimi i atyre që konstatohen në proces dhe njoftimi i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit për vazhdimin e procedurave të mëtëjshme.

Ndihmë në raste fatkeqësie natyrore ose aksidentesh të ndryshme dhe raste emergjencash civile, duke dhënë ndihmë të dëmtuarvë në rast urgjence

Marrja e masave në ruajtjen e rendit kur ka grumbullime njerëzish gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme

Zbatimi e detyrave të përcaktuara në Planet e Masave, duke planizuar shërbime për garantimin e zhvillimit normal të aktiviteteve masive të organizuara nga Bashkia ose me lejen e Bashkisë Kamez.

Njoftimi i Policisë së Shtetit dhe marrja e masave për sigurimin e vendit të ngjarjes, në rast të ndodhjes së veprave penale dhe me mbërritjen e zonës hetimor vihet në dispozicion të tij.

Respektimi i dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjediset publike.

Kontrolli i respektimit të orarit të shërbimit të njësive tregtare, bufeve, restoranteve, bilardove, lojërave të fatit e të objekteve të tjera me veprimtari publike, si dhe zbatimin nga ana e tyre të akteve të nxjerra nga organet kompetente në bashki.

Sigurimi i qetësisë publike, duke shmangur zëniet, menjanuar zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, altoparlanteve e megafoneve, rënia pa vend e borive të automjeteve në rrugë e mjedise të tjera publike që sjellin shqetësime për të tjerët.

Ruajtja e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike, si dhe heqja e atyre të paautorizuara

Marrja e masave (të përkohshme) për shoqërim në institucione ndaj të sëmurëve psikikë në gjëndje të rëndë që krijojnë shqetësime për rendin publik, si dhe largimin e lypsave nga rruga

Zbatimi i detyrave të tjera ligjore që ngarkohen nga organet e qeverisjes vendore por që nuk janë të parashikuara shprehimisht në ligjin organik

Bashkëpunimi me drejtoritë e tjera të Bashkisë duke dhënë mbështetjen ligjore sa herë që kërkohet me qëllim mbarvajtjen e punëve në Bashkinë e Tiranës.

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese, duke dhënë dhe kërkuar asistencë në çdo rast që nevojitet.

Veprimtaria e Policisë Bashkiake, mbështetet në kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake”, në funksion të zbatimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe urdhërave të Kryetarit të Bashkisë.

Objektivat kryesore të policisë Bashkiake për vitin 2020 janë:

Rritja e prezencës, vendosja e rregullit dhe kontrollit të plotë, në të gjithë territorin e Bashkisë Kamez, nga shërbimet e Policisë Bashkiake, nepërmjet rritjes së numrit të mjeteve logjistike, brenda vitit 2020.

Përmirësimi dhe rritja e treguesve të matshëm të punës së Policisë Bashkiake, që konsistojnë në parandalimin, konstatimin e ndeshkimit e kundërvajtjeve administrative objekt i punës sonë (ndërtimet pa leje, ndotje mjedisi, etj), duke zbatuar Rregulloren “Për rregullat dhe kushtet e zëniës së hapësirës publike në Bashkinë e Kamez”, si dhe zbatimin e Urdhrave të Kryetarit dhe Vendimeve të Këshillit Bashkiak, që ngarkojnë me detyra PB, gjatë vitit 2020.

Evidentimin dhe marrjen e masave konkrete ndeshkuese, për eliminimin e informalitetit në transportin publik dhe atë taksit, si edhe të stacioneve të paligjshme të krijuara në mënyrë abuzive nga subjekte transporti udhëtarësh, apo persona pa licencat perkatese, duke rritur bashkëpunimin me strukturat e Policisë së shtetit, si dhe duke përqendruar forca të mjeteve shtesë ndaj fenomeneve të tilla, në pikat hyrëse dhe dalje të qytetit të Kamzës, si edhe në zonat pranë.

Rritja në një nivel më të lartë të profesionalizmit, komunikimit, paraqitjes së jashtme, imazhit, si dhe prezantimit në publik të efektivave të Policisë Bashkiake, për t’ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi ankesave e kërkesave/ankesave gjithnjë e më rritje të komunitetit, n.p.m kryerjes së trajnimit, që do të zhvillohet në Akademinë e Sigurisë, dhe Policinë Bashkiake Tiranë në zbatim të marrëveshjes së nënshkruar midis Kryetarit të Bashkisë Kamez dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për Bashkëpunimin, formimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë Bashkiake”.

Përmirësimi i bazës ligjore të funksionimit të Policisë Bashkiake, duke analizuar situatën dhe dinamikën e paraqitur në terren, si dhe duke propozuar ndryshime perkatese, në funksion të zhvillimit të organizatës, brenda vitit 2020.

Marrja e masave të plota, për ruajtjen e rendit dhe qetësisë, mënjanimin e zhurmave që shqetësojnë komunitetin, në aktivitetet artistike, kulturore e sportive, si dhe festat e zhvilluara e organizuara nga Bashkia e Kamez, gjatë vitit 2020.

Forcimi i kontrollit të shërbimit ndaj efektivave të Policisë Bashkiake, duke vazhduar procesin e pastrimit të radhëve nga të paaftët e të korruptuarit, duke ndëshkuar me masa disiplinore dhe propozime për largime nga detyra, të gjithë punonjësve që do të konstatohen me shkelje në detyrë, deri në kallëzime për ndjekje penale, nëse do të konstatohen vepra penale, të kryera nga punonjësit e Policisë Bashkiake, me qëllim rritjen e disiplinës dhe përgjegjësisë, në kryerjen e detyrave të ngarkuara me Ligj, gjatë gjithë vitit 2020.

Rritja në një nivel më të lartë të bashkëpunimit, si dhe mbështetja e pakursyer, Drejtorive dhe Institucioneve të tjera të Bashkisë, për realizimin e detyrave dhe projekteve të planifikuara prej tyre, si dhe në rritja e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe Institucione të tjera Ligjzbatuese, duke u bazuar në dispozitat ligjore, gjatë gjithë vitit 2020.

Afrimi i punonjesve te Policise Bashkiake, sa me prane komunitetit, duke marre takime periodike me Administratoret, nderlidhesat me komunitetin, administratoret e pallateve, komunitetin e biznesit, shtimin e orareve te pritjes se publikut ne zyrat e PB etj., me qellim shkembimin e informacionit dhe dhenien e ndihmës reciproke, gjate gjithë vitit 2020.

Kryerja e proceseve transparente te rekrutimeve te reja, bazuar ne Ligjin per Policine Bashkiake, duke synuar ne perzgjedhjen e kandidatave me cilësore, si dhe rritjen e numrit te punonjeseve femra, ne drejtim te permirsimit te kuotave te barazise gjinore